Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0557

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Conex" L.L.C. kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër te prokurimit:635-26-580-2-2-1, me 08/09/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Conex" L.L.C. me nr. 2026/0557, e datës 30/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit: 635-26-580-2-2-1

2. Anulohet njoftimi për dhënie te kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit 635-26-580-2-2-1 **te kthehet ne rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. **Lejohet** kthimi i tarifes së ankeses në shumen e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Conex" L.L.C.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13/02/2026, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit: 635-26-580-2-2-1.

Me 20/07/2026, OE "Conex" L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 30/07/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Conex" L.L.C. me nr. 0557/2026 lidhur me aktivitetin "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit: 635-26-580-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Conex" L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rrënimi i objekteve të shpronësuara nga Komuna e Pejës", me nr. të prokurimit 635-26-580-2-2-1, Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur që oferta jonë të refuzohet me arsyetimin se është ofertë me çmim jo-normalisht të ulët, duke mos i marrë parasysh sqarimet tona të datës 06.07.2026, të paraqitura sipas kërkesës së AK-së, si dhe faktet dhe provat e paraqitura nga ana jonë.

Nga mënyra e veprimit të AK-së rezulton se sqarimet tona nuk janë shqyrtuar në mënyrë objektive dhe të plotë, ndërsa arsyetimi i dhënë për eliminimin e ofertës sonë nuk mbështetet në fakte dhe prova konkrete. Përkundrazi, nga rrethanat e procedurës krijohet përshtypja se qëllimi i AK-së ka qenë eliminimi i ofertës sonë dhe rekomandimi për kontratë i një operatori tjetër ekonomik, i cili, sipas të dhënave të procedurës, ka qenë i rekomanduar dhe shpërblyer me kontratë edhe në procedurat paraprake.

I. ARSYETIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR ELIMINIMIN E OFERTËS SONË

Në Njoftimin për Refuzim të Ofertës – OE "DARDANIAA" SH.P.K.; "CONEX" L.L.C., AK ka dhënë këtë arsyetim për mospranimin e sqarimeve tona:

Arsyetimi për mospranimin e sqarimeve të Operatorit Ekonomik lidhur me tenderin jo-normalisht të ulët

Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të përgjigjes së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë "DARDANIAA" SH.P.K.; "CONEX" L.L.C., në përgjigje të kërkesës së Autoritetit Kontraktues (B41 – Kërkesë për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët), ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur shpjegime lidhur me mënyrën e realizimit të punimeve dhe

formimin e çmimeve të ofertuara.

Megjithatë, sipas Komisionit të Vlerësimit, shpjegimet e dhëna kanë mbetur në nivel deklarativ dhe nuk janë mbështetur me dokumente dhe dëshmi objektive, të cilat ishin kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues për të provuar realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës.

Në kërkesën B41, Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që, për secilin pozicion të Paramasës dhe Parallogarisë, të paraqiteshin analiza të detajuara të kostove dhe dokumentacion mbështetës për elementet përbërëse të çmimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kostot e fuqisë punëtore, makinerive dhe pajisjeve, transportit, deponimit të materialit, derivateve, mirëmbajtjes, amortizimit, shpenzimeve operative dhe fitimit, si dhe çdo dokument tjetër që do të mundësonte verifikimin objektiv të realizueshmërisë së ofertës.

Nga shqyrtimi i përgjigjes së Operatorit Ekonomik, sipas AK-së, është konstatuar se, ndonëse janë dhënë shpjegime për mënyrën e organizimit të punimeve dhe janë përmendur burimet njerëzore dhe pajisjet në dispozicion, nuk janë dorëzuar dokumente dhe prova objektive që mbështesin këto pretendime dhe që dëshmojnë se çmimet e ofertuara mbulojnë të gjitha kostot e nevojshme për realizimin e kontratës.

Komisioni ka vlerësuar se dokumentet e dorëzuara në fazën e ofertimit lidhur me personelin dhe pajisjet shërbejnë për të dëshmuar përmbushjen e kritereve të kualifikimit dhe kapacitetin teknik të Operatorit Ekonomik, por nuk përbëjnë prova për realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të ofertuara dhe nuk zëvendësojnë dokumentacionin e kërkuar në procedurën e shqyrtimit të tenderit jo-normalisht të ulët.

Po ashtu, Operatori Ekonomik, sipas Komisionit, nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që do të mundësonte verifikimin e analizës së kostove për çmimet e ofertuara prej 2.80 €/m³, 1.50 €/m³ dhe 1.70 €/m³, si dhe nuk ka paraqitur prova objektive që vërtetojnë se me vlerën e përgjithshme të ofertës prej 58,850.00 € mund të realizohen të gjitha obligimet kontraktuale në përputhje me Specifikimet Teknike, Paramasën, Kushtet e Kontratës dhe standardet e kërkuara të cilësisë.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se nuk mund ta bazojë vlerësimin e realizueshmërisë së ofertës vetëm në deklarimet e Operatorit Ekonomik dhe se barra për të provuar realizueshmërinë e ofertës i takon Operatorit Ekonomik, përmes paraqitjes së provave dhe dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm.

Në mungesë të këtyre provave, sipas AK-së, nuk ka qenë e mundur të verifikohej objektivisht realizueshmëria ekonomike dhe teknike e ofertës.

Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar se sqarimet e dorëzuara nuk i përmbushin kërkesat e përcaktuara në letrën B41 dhe nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të konstatuar se oferta është ekonomikisht dhe teknikisht e realizueshme.

Për këtë arsye, sqarimet nuk janë pranuar si të mjaftueshme dhe oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. është refuzuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloret përkatëse që rregullojnë trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët.

II. SQARIMET E PARAQITURA NGA GOE “DARDANIAA SH.P.K. & CONEX L.L.C.”

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për sqarime lidhur me ofertën me çmim jo-normalisht të ulët është dërguar më 03.07.2026, ndërsa nga ana jonë sqarimet janë dorëzuar më 06.07.2026, brenda afatit të përcaktuar nga AK.

Sqarimet tona janë përgatitur në mënyrë të detajuar për secilin pozicion të Paramasës dhe Parallogarisë dhe kanë përmbajtur shpjegime lidhur me mënyrën e realizimit të punimeve, makineritë në dispozicion, numrin e punëtorëve, organizimin e punimeve dhe elementet që ndikojnë në formimin e çmimeve të ofruara.

[Këtu vendosen sqarimet dhe provat e dorëzuara nga GOE më 06.07.2026, sipas dokumenteve të bashkëngjitura.]

III. OFERTA JONË NUK PËRBËN OFERTË ME ÇMIM JO-NORMALISHT TË ULËT

Bazuar në Vendimin e Autoritetit Kontraktues pas rivlerësimit, rezulton se është shpallur një Operator Ekonomik i suksesshëm, një Operator Ekonomik i pasuksesshëm, ndërsa ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë, jemi eliminuar nga procedura.

Ndërkohë, të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e ofertës.

Arsyetimi për eliminimin tonë nuk qëndron, pasi oferta jonë nuk është me çmim jo-normalisht të ulët. Kjo dëshmohet edhe përmes aplikimit të formulës së përcaktuar në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht lidhur me mënyrën e përcaktimit të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët, si dhe në kuptim të nenit 61 të LPP-së.

Ofertat e paraqitura në këtë aktivitet të prokurimit janë:

- Albani AA LLC – 75,250.00 € – OE i rekomanduar për kontratë;
- GOE Dardania SH.P.K. & Conex L.L.C. – 58,850.00 € – oferta jonë;
- Horn & Co Kosova SH.P.K. – 84,450.00 €.

Totali i ofertave:

75,250.00 € + 58,850.00 € + 84,450.00 € = 218,550.00 €

Mesatarja e ofertave:

218,550.00 € ÷ 3 = 72,850.00 €

Pragu prej 30%:

72,850.00 € ÷ 1.30 = 56,038.46 €

Rrjedhimisht, sipas formulës së aplikuar, ofertat që janë nën vlerën 56,038.46 € do të konsideroheshin si oferta me çmim jo-normalisht të ulët, ndërsa oferta jonë prej 58,850.00 € është mbi këtë prag.

Për këtë arsye, qëndrimi i Autoritetit Kontraktues se oferta jonë është me çmim jo-normalisht të ulët është i pabazuar në kriterin matematik të përcaktuar për këtë qëllim.

Nga kjo rezulton se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar në mënyrë të gabuar kriterin për përcaktimin e ofertës me çmim jo-normalisht të ulët dhe, si rrjedhojë, na ka eliminuar nga procedura pa një bazë të qëndrueshme objektive.

Për më tepër, oferta jonë është 16,400.00 € më e lirë se oferta e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Kjo rrethanë duhet të merret në konsideratë edhe nga aspekti i parimeve të ekonomicitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e mjeteve publike, të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

IV. MOSMARRJA PARASYSH E SQARIMEVE TONA TË DATËS 06.07.2026

Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë në konsideratë në mënyrë të duhur dhe të plotë sqarimet tona të dorëzuara më 06.07.2026.

Ne, si GOE, kemi paraqitur sqarime të hollësishme lidhur me secilin pozicion, duke shpjeguar mënyrën e realizimit të punimeve, makineritë që do të përdoren, numrin e punëtorëve, organizimin e punës dhe mënyrën e formimit të çmimeve.

Në këtë drejtim, neni 61 i LPP-së përcakton se, gjatë vlerësimit nëse një tender është ose duket të jetë me çmim jo-normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të marrë parasysh shpjegimet e tenderuesit lidhur me:

- ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve ose të metodave të ndërtimit;
- zgjidhjet teknike të ofruara;
- kushtet veçanërisht të favorshme që Operatori Ekonomik ka në dispozicion për furnizimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose realizimin e punëve; dhe
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të propozuara.

Ne, si GOE, kemi paraqitur sqarime të plota dhe të argumentuara në përputhje me kërkesën e AK-së dhe me kriteret e përcaktuara në nenin 61 të LPP-së.

Megjithatë, nga arsyetimi i AK-së nuk rezulton se këto sqarime janë analizuar në mënyrë konkrete, individuale dhe objektive. Përkundrazi, AK është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se sqarimet kanë qenë deklarative dhe se nuk kanë qenë të mbështetura me dokumentacion të mjaftueshëm.

V. AFATI I SHKURTËR I CAKTUAR PËR PARAQITJEN E SQARIMEVE

Gjithashtu, vlen të theksohet se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës – na ka dërguar kërkesën për sqarime më 03.07.2026, në orën 14:30, ndërsa afati për përgjigje është përcaktuar deri më 06.07.2026.

Pra, kërkesa është dërguar të premten, pak para përfundimit të orarit zyrtar të punës, ndërsa përgjigjja është kërkuar deri të hënën.

Duke marrë parasysh orarin e punës së administratës publike, nga e hëna deri të premten, si dhe faktin se ditët e shtunë dhe e diel nuk janë ditë pune, afati i dhënë për përgatitjen e sqarimeve ka qenë jashtëzakonisht i shkurtër, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën e detajuar të kërkesave të AK-së.

Megjithatë, pavarësisht këtij afati të shkurtër dhe kërkesave të detajuara të AK-së, ne kemi arritur ti përgatisim dhe ti dorëzojmë sqarimet brenda afatit të kërkuar.

Kjo rrethanë duhet të merret parasysh në vlerësimin e mënyrës së veprimit të Autoritetit Kontraktues dhe të objektivitetit të trajtimit të ofertës sonë.

VI. PROCEDURA E MËPARSHME DHE VENDIMI I OSHP-së

Edhe herën e parë, Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar nga procedura.

Duke vlerësuar se eliminimi ynë ishte i pabazuar, ne, si GOE, kemi shfrytëzuar të drejtën tonë ligjore dhe kemi paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

OSHP e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe e ka kthyer lëndën në rivlerësim.

Pas këtij vendimi, kemi pritur që Autoriteti Kontraktues ta respektojë dhe zbatojë plotësisht Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0320, të datës 24.06.2026.

Megjithatë, pas rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues përsëri na ka eliminuar nga procedura përmes vendimit të rivlerësimit të ofertave të datës 14.07.2026.

Ky vendim është marrë tetë (8) ditë pas dorëzimit të sqarimeve tona të datës 06.07.2026, pa u mbështetur në një analizë konkrete dhe objektive të sqarimeve të paraqitura nga ana jonë.

Ne, si GOE, i kemi qëndruar dhe vazhdojmë tu qëndrojmë çmimeve të ofruara në ofertën tonë dhe jemi të gatshëm që, në rast të dhënies së kontratës, të realizojmë të gjitha obligimet kontraktuale sipas kushteve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe kontratë.

Po ashtu, jemi të gatshëm të paraqesim sigurimin e ekzekutimit në vlerën prej 10% të kontratës, sipas kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, i cili do të mbetet i vlefshëm për periudhën e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Në sqarimet tona kemi elaboruar në mënyrë të detajuar secilin pozicion, duke paraqitur makineritë, numrin e punëtorëve dhe mënyrën e realizimit të punimeve. Për këtë arsye, nuk ekziston asnjë bazë objektive për të konstatuar se oferta jonë është ekonomikisht ose teknikisht e parealizueshme.

VII. DALLIMI I ÇMIMEVE ME OFERTËN E OPERATORIT TË REKOMANDUAR

Po ashtu, vlen të theksohet një rrethanë me rëndësi për vlerësimin e pretendimit të AK-së lidhur me realizueshmërinë e çmimeve.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nga Komuna e Pejës, OE “Albani AA LLC”, ka ekzekutuar edhe kontratën paraprake me titull të njëjtë, me nr. të prokurimit 635-25-3777-2-2-1.

Në atë procedurë, në pozicionin nr. 2, ky operator ekonomik ka ofertuar çmimin prej 2.00 €, ndërsa në procedurën aktuale ka ofertuar çmimin prej 2.50 €.

Në këto rrethana, shtrohet pyetja se si ka qenë e mundur që i njëjti Operator Ekonomik ta realizojë kontratën paraprake me çmimin prej 2.00 €, ndërsa në procedurën aktuale pretendohet se çmimet tona nuk janë të realizueshme, ndonëse çmimet e ofruara nga ne janë në një nivel të

tillë që, sipas llogaritjes së mësipërme, nuk e kalojnë pragun e përcaktuar për ofertë me çmim jo-normalisht të ulët.

Nëse në periudhën nga viti 2025 deri më tani nuk kanë ndodhur ndryshime të konsiderueshme në treg që do ta bënin të pamundur realizimin e punëve me këto çmime, atëherë kjo rrethanë duhet të analizohet nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë objektive dhe të arsyetuar.

Kjo situatë krijon dyshime serioze lidhur me qëndrueshmërinë e arsyetimit të AK-së për eliminimin e ofertës sonë dhe kërkon që OSHP të shqyrtojë nëse vlerësimi i realizueshmërisë së ofertës sonë është bërë mbi baza objektive dhe të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë.

VIII. SHKELJA E PARIMEVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejës, së bashku me Komisionin e Vlerësimit, nuk i ka zbatuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit në mënyrë të barabartë dhe objektive.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se është cenuar neni 59 i LPP-së, pasi oferta jonë është eliminuar pa u bërë një vlerësim i plotë i fakteve, provave dhe sqarimeve të dorëzuara nga ana jonë.

Po ashtu, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, pasi nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të argumentuar të gjitha çështjet e ngritura nga ana jonë.

Në vend që të bëhej një vlerësim objektiv i ofertës sonë dhe sqarimeve të paraqitura, AK është bazuar në konstatime të përgjithshme, duke na eliminuar në bazë të nenit 61 të LPP-së, ndërkohë që, sipas qëndrimit tonë, pikërisht mënyra e aplikimit të kësaj dispozite nga AK përbën shkelje të saj.

Gjithashtu, konsiderojmë se nuk është zbatuar drejt kriteri i përcaktuar në nenin 11 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik, lidhur me formulën dhe mënyrën e përcaktimit të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët.

Për këtë arsye, arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në një vlerësim të plotë të fakteve dhe provave.

IX. PRETENDIMET ANKIMORE LIDHUR ME OPERATORIN EKONOMIK TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË

Përveç kundërshtimit të eliminimit tonë, në vijim paraqesim edhe pretendimet ankimore lidhur me Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, OE “Albani AA LLC”, për të cilin konsiderojmë se nuk i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

1. Mospërmbushja e kriterit lidhur me referencat dhe kapacitetin teknik/profesional

Gjatë qasjes në dokumentacionin e ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar, kemi konstatuar se në listën e kontratave të paraqitura janë vetëm dy projekte.

Në Dosjen e Tenderit, lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional, është përcaktuar:

Kërkesa 1:

“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë ndërtimore në vlerë totale prej 120,000.00 Euro gjatë 3 (tri) viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit të operatorëve ekonomikë, udhëheqësi duhet të ketë realizuar së paku 60% të vlerës së kërkuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit.”

Nga ky kriter rezulton qartë se OE duhet të dëshmojë përmbushjen e vlerës së kërkuar prej 120,000.00 €, ndërsa në rastin e një grupi të operatorëve ekonomikë, lideri duhet të ketë realizuar së paku 60% të kësaj vlere.

Nga dokumentacioni i OE të rekomanduar rezulton se për dy projektet e paraqitura, Albani AA LLC ka qenë anëtar i konsorciumit dhe jo lider.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues është dashur të verifikojë, ndër të tjera, marrëveshjet e konsorciumit dhe dokumentacionin financiar përkatës, për të përcaktuar pjesën reale të vlerës së kontratave të realizuara nga Albani AA LLC.

Nëse marrëveshja e konsorciumit do të përcaktonte se lideri realizon 60% dhe anëtari 40%, atëherë kalkulimi do të ishte:

120,000.00 € × 60% = 72,000.00 € – pjesa e liderit;

120,000.00 € × 40% = 48,000.00 € – pjesa e anëtarit, Albani AA LLC.

Në këtë rast, Albani AA LLC nuk do ta përmbushte vetë kriterin prej 120,000.00 €, pasi pjesa e saj do të ishte vetëm 48,000.00 €.

Prandaj, shtrohet çështja se në çfarë mënyre Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se OE i rekomanduar e përmbush kriterin e kërkuar, kur në projektet e paraqitura ky operator ekonomik ka qenë anëtar i grupit dhe jo lider.

Kjo çështje është dashur të verifikohet në mënyrë konkrete përmes dokumentacionit të dorëzuar nga OE dhe, nëse ka qenë e nevojshme, përmes dokumenteve mbështetëse të kërkuara sipas dispozitave përkatëse të LPP-së.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar në mënyrë të barabartë kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit, ndërsa kjo çështje ndikon drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e ofertës së OE të rekomanduar.

2. Mospërmbushja e kriterit lidhur me makineritë dhe pajisjet

Po ashtu, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional – Lista e mjeteve dhe pajisjeve.

Në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kërkuar:

Kërkesa 3 – Lista e mjeteve të punës:

1. Kamion minimum 10 m³ – minimum 1 copë;
2. Eskavator me goma – minimum 1 copë;
3. Kamion – minimum 1 copë;
4. Kompresor – minimum 2 copë;

5. Hilt – minimum 2 copë.

Si dëshmi është kërkuar:

“Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat apo të kontraktuara (apo me qira në emër të këtij projekti për kohëzgjatjen e kontratës), të dëshmohen me kopje të librezave, deklaratë doganore (DUD). Të dëshmohet se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid – kopja e librezave të pajisjeve. OE të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen nga ky aktivitet i prokurimit.”

Nga dokumentacioni i OE të rekomanduar, gjatë qasjes në dosjen e ofertës, kemi konstatuar probleme lidhur me dëshmimin e pajisjeve të kërkuara.

Kompresorët

Për kompresorët – minimum 2 copë, OE i rekomanduar nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme.

Në vend të dokumentit të kërkuar, është paraqitur një fotografi dhe një dokument lidhur me kompresorin, i cili nuk mund të identifikohet qartë si DUD apo faturë, për shkak se dokumenti është i paqartë, i palexueshëm dhe nuk mundëson verifikimin e të dhënave përkatëse.

Në këto rrethana, shtrohet pyetja se si Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit kanë mundur ta verifikojnë se dokumenti i paraqitur dëshmon pikërisht pajisjen e kërkuar dhe se ajo përmbush kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Provë: Dokumenti i paraqitur nga OE për kompresorin, i cili është i palexueshëm.

Nga dokumenti i paraqitur nuk mund të deshifrohen të dhënat thelbësore, prandaj nuk mund të konstatohet në mënyrë objektive se bëhet fjalë për kompresorin e kërkuar, e aq më pak të verifikohet pronësia, identifikimi dhe statusi i tij sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

3. Mungesa e dëshmive për Hilt-at

Po ashtu, për pajisjet Hilt – dy (2) copë, OE i rekomanduar nuk ka paraqitur pajisjet në listën përkatëse dhe as nuk ka bashkëngjitur ndonjë marrëveshje për sigurimin e tyre.

Në këto rrethana, shtrohet pyetja se si Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit kanë mundur ta konsiderojnë ofertën të përgjegjshme, kur një nga kërkesat e përcaktuara shprehimisht në Dosjen e Tenderit nuk është dëshmuar.

Mungesa e dëshmisë për pajisjet e kërkuara duhet të vlerësohet në kuadër të nenit 59 të LPP-së dhe kritereve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Për këtë arsye, konsiderojmë se OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kriterin e kërkuar për listën e pajisjeve dhe, rrjedhimisht, përgjegjshmëria e ofertës së tij duhet të rivlerësohet.

4. Mospërmbushja e kriterit lidhur me stafin teknik

Gjatë qasjes në dosjen e Operatorit Ekonomik të rekomanduar kemi vërejtur gjithashtu çështje lidhur me kriterin për stafin teknik.

Në Dosjen e Tenderit janë kërkuar 5 punëtorë sipas profileve përkatëse.

OE i rekomanduar ka dorëzuar një listë të ATK-së të datës 09.03.2026, në të cilën janë evidentuar pesë emra.

Megjithatë, nga dokumentacioni i qasur nuk rezulton në mënyrë të qartë profesioni dhe profili i këtyre punëtorëve, pasi nuk janë paraqitur kontrata të punës ose dokumente të tjera përkatëse që do të mundësonin verifikimin e profileve të tyre profesionale.

Po ashtu, nga lista e paraqitur rezulton se kontributet e punëtorëve janë evidentuar për muajin janar, ndërsa nuk rezulton dëshmi për pagesën e kontributeve për muajt shkurt, mars dhe muajt vijues.

Për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues është dashur të verifikojë nëse stafi i paraqitur nga OE i rekomanduar i përmbush kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, veçanërisht sa i përket profileve profesionale dhe marrëdhënies së punës.

Mosverifikimi i këtyre rrethanave përbën, sipas qëndrimit tonë, cenim të parimit të vlerësimit të ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

5. Mospërputhja lidhur me specifikimin teknik

Nga qasja në dosjen e OE të rekomanduar kemi vërejtur gjithashtu se Specifikimi Teknik i detyrueshëm nuk është nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik.

Specifikimi teknik është dokument i rëndësishëm i ofertës, përmes të cilit ofertuesi duhet të deklarojë pranimin dhe përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë arsye, mosnënshkrimi dhe mospajisja me vulë e dokumentit përkatës duhet të vlerësohet nga Autoriteti Shqyrtues në raport me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit dhe rëndësinë që ka ky dokument në ofertë.

Konsiderojmë se kjo rrethanë është dashur të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të përgjegjshmërisë së ofertës.

6. Certifikata e biznesit dhe mungesa e informatave shtesë

Gjatë qasjes në dosjen e Operatorit Ekonomik të rekomanduar kemi vërejtur gjithashtu se Certifikata e Biznesit nuk i ka të bashkëngjitura informatat shtesë.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi që, nëse e ka konsideruar të nevojshme, të kërkojë sqarimin ose plotësimin e informacionit përkatës në përputhje me dispozitat e nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Fakti që kjo çështje nuk është trajtuar dhe verifikuar, ndërsa oferta është konsideruar e përgjegjshme, krijon shqetësim lidhur me zbatimin e barabartë të kritereve ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se është cenuar edhe neni 7 i LPP-së, lidhur me trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin e operatorëve ekonomikë.

X. KONKLUZIONI LIDHUR ME PËRGJEGJSHMËRINË E OFERTAVE

Nga të gjitha faktet e paraqitura më lart rezulton se Autoriteti Kontraktues:

1. na ka eliminuar si GOE me arsyetimin se oferta jonë është me çmim jo-normalisht të ulët, ndonëse oferta jonë prej 58,850.00 € është mbi pragun e kalkuluar prej 56,038.46 €;
2. nuk i ka marrë në konsideratë në mënyrë të plotë dhe objektive sqarimet tona të datës 06.07.2026;
3. nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe konkret lidhur me arsyet pse sqarimet tona nuk janë konsideruar të mjaftueshme;
4. ka rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik, përgjegjshmëria e të cilit, sipas pretendimeve tona, është e kontestueshme për shkak të mosplotësimit të disa kritereve të Dosjes së Tenderit;
5. nuk ka verifikuar në mënyrë të mjaftueshme përmbushjen e kriterit lidhur me referencat dhe pjesën e realizuar nga OE "Albani AA LLC" në kuadër të konsorciumeve;
6. nuk ka verifikuar në mënyrë të mjaftueshme dokumentacionin lidhur me kompresorët;
7. nuk ka verifikuar mungesën e dëshmive për dy Hilt-at e kërkuar;
8. nuk ka verifikuar në mënyrë të plotë përmbushjen e kriterit lidhur me stafin teknik;
9. nuk ka trajtuar çështjen e specifikimit teknik të panënshkruar dhe të pavulosur;
10. nuk ka trajtuar në mënyrë të duhur çështjen e Certifikatës së Biznesit dhe informatave shtesë;
11. nuk ka zbatuar në mënyrë të barabartë kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit; dhe
12. ka rekomanduar një ofertë që është 16,400.00 € më e shtrenjtë se oferta jonë, ndonëse ne kemi paraqitur ofertë më të lirë dhe kemi deklaruar gatishmërinë për realizimin e plotë të kontratës.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se eliminimi ynë si GOE është i pabazuar dhe se oferta jonë është trajtuar në mënyrë jo të barabartë në raport me Operatorin Ekonomik të rekomanduar.

Konsiderojmë gjithashtu se veprimet e Autoritetit Kontraktues kanë rezultuar në një situatë ku një ofertë më e shtrenjtë është rekomanduar për kontratë, ndërsa oferta jonë, e cila është 16,400.00 € më e lirë, është eliminuar për një arsye që, sipas llogaritjeve dhe argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, nuk qëndron.

Kjo situatë duhet të vlerësohet edhe në raport me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit të prokurimit publik, si dhe me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

XI. KËRKESA

Bazuar në të gjitha pretendimet ankimore, faktet, provat dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që:

1. ta aprovojë ankesën tonë si të bazuar;
2. të konstatojë se eliminimi i GOE DARDANIAA SH.P.K. & CONEX L.L.C. nga procedura e prokurimit është i pabazuar;
3. të konstatojë se oferta jonë nuk është ofertë me çmim jo-normalisht të ulët sipas kriterit dhe formulës së përcaktuar nga legjislacioni përkatës;
4. të vlerësojë dhe marrë parasysh sqarimet e dorëzuara nga ana jonë më 06.07.2026;

5. të konstatojë nëse Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenet përkatëse të LPP-së, përfshirë nenet 7, 59, 61, 69, 72 dhe 108/A, si dhe dispozitat përkatëse të udhëzuesve dhe rregulloreve të prokurimit publik;
6. të shqyrtojë përgjegjshmërinë e Operatorit Ekonomik Albani AA LLC, veçanërisht lidhur me përmbushjen e kritereve të referencave, pajisjeve, stafit teknik dhe dokumentacionit tjetër të kërkuar në Dosjen e Tenderit;
7. të konstatojë nëse rekomandimi për kontratë i OE të lartcekur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit;
8. nëse pas shqyrtimit konstatohet se oferta jonë është e përgjegjshme dhe përmbush të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë vlerësimin dhe renditjen e ofertave në përputhje me LPP-në dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;
9. të marrë parasysh dëmin potencial ndaj buxhetit publik që rezulton nga rekomandimi i një oferte 16,400.00 € më të shtrenjtë se oferta jonë; dhe
10. të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet që i konsideron të nevojshme sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Lidhur me pretendimet tona për përgjegjësinë profesionale të Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit dhe veprimet e tij në këtë procedurë, kërkojmë që OSHP, në kuadër të kompetencave të saj ligjore, të vlerësojë nëse ekzistojnë kushtet për ndërmarrjen e masave të parashikuara me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim, kërkojmë që të gjitha faktet, provat dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë të shqyrtohen në mënyrë të plotë, objektive dhe të paanshme, me qëllim që të sigurohet zbatimi i drejtë i legjislacionit të prokurimit publik dhe trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë.

Ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë DARDANIAA SH.P.K. & CONEX L.L.C., kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme, me çmim më të ulët, kemi dhënë sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe kemi deklaruar gatishmërinë tonë për realizimin e kontratës në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për shkak të padrejtësive që konsiderojmë se na janë bërë gjatë kësaj procedure, do ti shfrytëzojmë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj pranë organeve kompetente, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave tona dhe të sigurimit të një procedure të drejtë, transparente dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Bazuar në pretendimet e paraqitura më lart, kërkojmë nga OSHP që ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe të ndërmerren masat përkatëse në përputhje me kompetencat ligjore.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/08/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0557/2026, ndërsa me datë 10/08/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0557/2026, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Conex" L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0557 ka vlerësuar si në vijim:

GOE " Dardania & Conex L.L.C" - Prishtinë, aktiviteti i prokurimit me titull: "Rrënimi i objekteve të shpronësuara nga Komuna e Pejës", me nr. të prokurimit: 635-26-580-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Pejës, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës kontratë publike kornizë -shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës është 120,000.00 € për 24 Muaj. Ndërsa, kriter i dhënies së kontratës është "Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët".

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër eliminimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues, ku kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, ndërsa ekspertja shqyrtuese ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.320/2026, të datës 26.05.2026. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.2026/0320, të datës 24.06.2026, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE "Dardania & Conex L.L.C" - Prishtinë, kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 24, 25, 56.3, 59, 60, 61 dhe 108/A të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Udhëzuesit të Prokurim Publik, konkretisht të nenit 11 të Udhëzuesit. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se AK-Komuna e Pejës, nuk i ka marrë parasysh sqarimet e dorëzuara më datë 06.07.2026, të cilat janë ofruar në përgjigje të kërkesës së AK-së për sqarime lidhur me mënyrën e formimit të çmimeve të ofertuara për secilin pozicion të paramasës dhe parallogarisë. Tutje, OE ankues potencon se arsyeja e eliminimit nga AK është si vijon:

Njoftim për Refuzim të Ofertës –OE DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C.

Arsyetimi për mospranimin e sqarimeve të Operatorit Ekonomik lidhur me tenderin jo normalisht të ulët Komisioni i Vlerësimit, pas shqyrtimit të përgjigjes së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. në përgjigje të kërkesës së Autoritetit Kontraktues (B41 – Kërkesë për informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët), ka konstatuar se Operatori Ekonomik ka paraqitur shpjegime lidhur me mënyrën e realizimit të punimeve dhe formimin e çmimeve të ofertuara. Megjithatë, shpjegimet e dhëna kanë mbetur në nivel deklarativ dhe nuk janë mbështetur me dokumente dhe dëshmi objektive, të cilat ishin

kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues për të provuar realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Në kërkesën B41, Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që për secilin pozicion të Paramasës dhe Parallogarisë të paraqiteshin analiza të detajuara të kostove dhe dokumentacion mbështetës për elementet përbërëse të çmimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kostot e fuqisë punëtore, makinerive dhe pajisjeve, transportit, deponimit të materialit, derivateve, mirëmbajtjes, amortizimit, shpenzimeve operative dhe fitimit, si dhe çdo dokument tjetër që do të mundësonte verifikimin objektiv të realizueshmërisë së ofertës. Nga shqyrtimi i përgjigjes së Operatorit Ekonomik është konstatuar se, ndonëse janë dhënë shpjegime për mënyrën e organizimit të punimeve dhe janë përmendur burimet njerëzore dhe pajisjet në dispozicion, nuk janë dorëzuar dokumente dhe prova objektive që mbështesin këto pretendime dhe që dëshmojnë se çmimet e ofertuara mbulojnë të gjitha kostot e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni vëren se dokumentet e dorëzuara në fazën e ofertimit lidhur me personelin dhe pajisjet shërbejnë për të dëshmuar përmbushjen e kritereve të kualifikimit dhe kapacitetin teknik të Operatorit Ekonomik, por ato nuk përbëjnë prova për realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të ofertuara dhe nuk zëvendësojnë dokumentacionin e kërkuar në procedurën e shqyrtimit të tenderit jo-normalisht të ulët. Po ashtu, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës që do të mundësonte verifikimin e analizës së kostove për çmimet e ofertuara prej 2.80 €/m³, 1.50 €/m³ dhe 1.70 €/m³, si dhe nuk ka paraqitur prova objektive që vërtetojnë se me vlerën e përgjithshme të ofertës prej 58,850.00 € mund të realizohen të gjitha obligimet kontraktuale në përputhje me Specifikimet Teknike, Paramasën, Kushtet e Kontratës dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta bazojë vlerësimin e realizueshmërisë së ofertës vetëm në deklarimet e Operatorit Ekonomik. Barra për të provuar realizueshmërinë e ofertës i takon Operatorit Ekonomik përmes paraqitjes së provave dhe dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm. Në mungesë të këtyre provave, Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë në gjendje të verifikojë objektivisht realizueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertës. Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit vlerëson se sqarimet e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në letrën B41 dhe nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të konstatuar se oferta është ekonomikisht dhe teknikisht e realizueshme. Për këtë arsye, sqarimet nuk pranohen si të mjaftueshme dhe oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; CONEX L.L.C. refuzohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloreve përkatëse që rregullojnë trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët.

Tutje OE ankues potencon se bazuar në shkresën e datës 06.07.2026 kanë dërguar përgjigje të detajuar AK-së.

Tutje OE ankues potencon se bazuar në vendimin e AK pas rivlerësimit, rezulton se është shpallur një Operator Ekonomik (OE) i suksesshëm, një OE i pasuksesshëm, ndërsa ne si GOE jemi eliminuar nga procedura. Ndërkohë, të gjithë operatorët e tjerë ekonomik nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e ofertës. Arsyetimi për eliminimin tonë nuk qëndron në asnjë aspekt, pasi oferta jonë nuk është me çmim jo-normalisht të ulët. Kjo dëshmohet edhe sipas formulës së përcaktuar në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht në nenin 11 dhe nenin 61 te LPP-së, i cili rregullon mënyrën e përcaktimit të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët.

Albani AA LLC – 75,250.00 € (OE i rekomanduar për kontratë)

GOE Dardania SH.P.K. & Conex L.L.C. – 58,850.00 € (oferta jonë)

Horn & Co Kosova SH.P.K. – 84,450.00 €

Totali i ofertave: 218,550.00 €

Mesatarja e ofertave: 218,550.00 € ÷ 3 = 72,850.00 €

Pragu prej 30%: 72,850.00 € ÷ 1.30 = 56,038.46 €

Prandaj, vetëm ofertat që janë nën vlerën 56,038.46 € konsiderohen oferta me çmim jo normalisht të ulët, ndërsa oferta jonë prej 58,850.00 € është mbi këtë prag dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet ofertë me çmim jo-normalisht të ulët. Nga kjo rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues, në mënyrë tendencioze, na ka eliminuar duke mos e zbatuar kriterin ligjor për përcaktimin e ofertës me çmim jo-normalisht të ulët. Për më tepër, jemi eliminuar padrejtësisht, ndonëse oferta jonë është 16,400.00 € më e lirë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Me këtë veprim, AK nuk ka respektuar parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e mjeteve publike, të përcaktuara në nenet 1 dhe 6 të Ligjit për Prokurimin Publik. Po ashtu, AK nuk i ka marrë fare parasysh sqarimet tona të dorëzuara më 06.07.2026, të cilat janë përgatitur dhe elaboruar në mënyrë të detajuar për secilin pozicion, në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik. Neni 61 i LPP-së përcakton se gjatë vlerësimit nëse një tender është apo duket të jetë me çmim jo-normalisht të ulët, autoriteti kontraktues duhet të marrë parasysh shpjegimet e tenderuesit lidhur me:

• ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve ose të metodave të ndërtimit;

• zgjidhjet teknike të ofruara;

• kushtet veçanërisht të favorshme që operatori ekonomik ka në dispozicion për furnizimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose realizimin e punëve; dhe

• origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve të propozuara.

Përgjigje në pretendimin ankimor: Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës konkretisht në Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 14.07.2026, si dhe arsyetimin e dhënë nga AK, pretendimin ankimor të OE ankues, dhe nga analiza e ofertave dhe zbatimi i formulës së përcaktuar në nenin 11 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, sqaroj se procedurën e trajtimit të tenderëve jo normalisht të ulët i rregullon neni 41 i Rregullores dhe sqarimet shtesë me të dhëna në formë tabelore i sqaron neni 11 i Udhëzuesit Nr. 02/2024. Në nenin 41 të Rregullores jepen 3 kushte kryesore që obligon AK për të kërkuar sqarime dhe shpjegime për çmimin e ofruar, ato kushte janë:

çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ngjashëm edhe në Udhëzuesin Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, në pikën 11 (Tenderët Jo-normalisht të ulët), shembulli 1 (tabela), jepen 3 kushte kryesore të ngjashme sikurse në nenin 41 të Rregullores, që në rastin konkret tek nr. rendor 11 i tabelës paraqitet kushti 3 "pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire".

Për tu kthyer të çështja e pretendimit ankimor të OE ankues, ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të nenit 41 të Rregullores është plotësuar kushti i parë (janë 3 oferta të përgjegjshme), çmimi mesatar i tre tenderëve të përgjegjshëm është përcaktuar 72,850.00 euro dhe pas llogaritjes (72,850.00 / 1.3 = 56,038.46€) rezulton se pragu minimal për tu konsideruar një tender jo normalisht i ulët është vlera 56,038.46 euro, kurse vlera e ofertës së OE ankues është 58,850.00 euro. Pra, në këtë rast oferta e OE ankues ka çmim më të lartë se pragu prej 56,038.46 euro, që do të thotë se AK në rastin konkret ka kërkuar sqarime apo shpjegime në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 41 të Rregullores. Andaj, meqenëse në rastin konkret ky tender nuk mund të konsiderohet me çmim jo normalisht të ulët, atëherë nuk vazhdohet me kushtin e tretë të përcaktuar në nenin 11 të Udhëzuesit. Andaj AK-ë konsideroj se nuk ka pasur bazë ligjore ta konsiderojë ofertën e OE ankues si ofertë me çmim jo-normalisht të ulët, pasi oferta e tij nuk i plotëson kushtet e nenit 11 të Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023, për t'u kualifikuar si e tillë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshëm pasi që nuk plotëson kërkesat e DT dhe të njoftimit për kontratë, ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues këto pretendime nuk i ka parashtruar tek kërkesa për rishqyrtim e datës 20.07.2026, andaj bazuar në nenin 64.2 të Rregullores nr. 001-2022 për Prokurim Publik në të cilën thuhet :

64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 14.07.2026 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit,

përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit 635-26-580-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar pa pasur nevoje qe te njejtat te perseriten. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rrënimi i objekteve te shpronësuara nga Komuna e Pejës" me numër të prokurimit 635-26-580-2-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **CONEX L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: